



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.968/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Illyrian Consulting Engineers” SH.P.K., me seli në rruga “ Sami Frashëri” Pallati Bjorn Kati 11, Tiranë, Republika e Shqipërisë përfaqësuar sipas autorizimit nga Alexandër Borg Olivier nga zyra ligjore “Abolivier & Associates L.L.C., rruga “Zenel Salihu”, nr.28, kati III/8, Prishtinë, kundër të paditurës 1.Organi Shqyrtues i Prokurimit tutje (OSHP), me seli në Prishtinë, adresa rruga “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lubjanës, Kati i V-të, përfaqësuar sipas autorizimit nga A.D. 2. Komuna e Shtërpcës, me seli në Shtërpcë, përfaqësuar sipas autorizimit nga H.A., për shkak të anulimit të Vendimit Nr. PSH.nr. 936/20 e datës 09.12.2020, Vendimi nr. 655-20-6077-2-1-3/20 i datës 03.11.2020, Vendimi nr. 02-030/01-11897/20 të datës 30.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 19.03.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit B.O. dhe të përfaqësuesit të palës së paditur Z. A.D., më datë 11.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Illyrian Consulting Engineers” SH.P.K., kundër të paditurit kundër të paditurit 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, 2. Komuna e Shtërpcës, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. PSH.nr. 936/20 e datës 09.12.2020, Vendimi nr. 655-20-6077-2-1-3/20 i datës 03.11.2020, Vendimi nr. 02-030/01-11897/20 të datës 30.10.2020, me çka ka kërkuar të anulohen aktet e kontestuara me padi të detyrohet e paditura Komuna e Shtërpcës që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej 17,600.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të detyrohet e paditura që

paditësit t'ia lëshoj një vërtetim me të cilin paditësit do ti njihet si shërbim eksperience për projektin “Hartimin e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit si dhe Hartës Zonale të Komunës së Shtërpçës dhe të detyrohet e paditura e dytë që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet procedurale si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 540.80 euro për pjesëmarrjen në dy seanca gjyqësore, shumë prej 208 euro për parashtrimin e padisë dhe shumë prej 50 euro të pagesës së taksës, **si e pabazuar**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 08.01.2021, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi “Illyrian Consulting Engineers” SH.P.K me seli në Tiranë, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr. 38/2021, kundër të paditurit 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, 2. Komuna e Shtërpçës, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. PSH.nr. 936/20 e datës 09.12.2020, Vendimi nr. 655-20-6077-2-1-3/20 i datës 03.11.2020, Vendimi nr. 02-030/01-11897/20 të datës 30.10.2020, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia e paditësit, të anulohen aktet e kontestuara me padi të detyrohet e paditura Komuna e Shtërpçës që paditësit ën emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguaj shumë prej 17,600.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të detyrohet e paditura që paditësit t'ia lëshoj një vërtetim me të cilin paditësit do ti njihet si shërbim eksperience për projektin. “Hartimin e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit si dhe Hartës Zonale të Komunës së Shtërpçës”, dhe të detyrohet e paditura e dytë që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet procedurale si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 540.80 euro për pjesëmarrjen në dy seanca gjyqësore, shumë prej 208 euro për parashtrimin e padisë dhe shumë prej 50 euro të pagesës së taksës.

2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 968/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit përgatitor më datë 07.02.2024, ndërsa më datë 19.03.2024 mbajti seancë të shqyrtimit kryesor dhe publik me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat B.O. nga zyra ligjore “Abolivier & Associates: L.L.C., sipas autorizimit të datës 05.01.2021 dhe të përfaqësuesit të palës së paditur OSHP Z. A.D. sipas autorizimit të datës 10.01.2024 dhe përfaqësuesit të paditurës Komunës së Shtërpcës, Z. H.A., sipas autorizimit të datës 28.12.2023.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se më datë 07.10.2020, e paditura Komuna e Shtërpcës, si autoritet kontraktues tutje AK, ka publikuar dosjen e konkursit të projektit “Hartimin e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit si dhe Hartës Zonale të Komunës së Shtërpcës”, në të cilin është përcaktuar procedura e tenderimit, ndërsa paditësi në kohë brenda afatit ligjit ka dorëzuar ofertën financiare bashk me dokumentacionet relevante. Më datë 30.10.2020, e paditura AK kishte nxjerr vendimin Nr. 02-030/01-11897/20 në të cilin e kishte anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se pas konsultimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, është vërejtur një gabim teknik në këto dokumente, ku theksohet se ofertat duhet të dorëzohen në formë fizike, por në një vend tjetër thuhet se oferta duhet të dorëzohen edhe përmes sistemit, ndërsa më datë 03.11.2020 kishte nxjerr njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit 655-20-6077-2-1-3, m si i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe apo arsyeve objektive të cilat janë jashtë kontrollit të AK-së, dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.
5. Nga paraqitja e gjendjes faktike dhe asaj juridike është e qartë që të paditurat me veprimet e tyre i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale paditësit, duke vepruar me keqbesim për sa i përket çështjes së respektimit të detyrimeve ligjore.

Paditësi nuk është në gjendje të realizoj fitimin sipas aktivitetit të prokurimit Nr. 655-20-6077-2-1-3, sepse e paditura e dytë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik, vendimin e kontestuar me padi dhe njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit ndërsa e paditura e parë me vendimin PSH.nr. 936/20 e datës 09.12.2020, edhe pse e aprovon ankesën e paditësit, nuk e anulon njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Arsyet e dhëna në njoftimin e të paditurës së dytë të datës 03.11.2020, janë në kundërshtim me arsyet të cilat i ka dhënë e paditura e dytë në vendimin e saj Nr. 02-030-01/-11897/20 të datës 30.10.2020, sepse lëshimet teknike nuk konsiderohen ngjarje objektive dhe të paparashikueshme, sepse në njoftimin për konkursin e projektimit dhe në dosjen e tenderit nuk shkruan se tenderët duhet të dorëzohen në formë fizike, por shprehimisht thuhet se tenderët duhet të dorëzohen përmes sistemit. E paditura e dytë nuk e ka respektuar nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik tutje (LPP-së), sepse anulimi i tenderit për shkaqet që ju ka referuar e paditura nuk është e lejuar me dispozitën e nenit 62 të LPP-së, ngase e paditura e ka përdorur dosjen standarde të publikuar nga KRPP-ja, dhe nuk ka bërë ndryshime të tjera, tenderët përgatiten duke u bazuar ekskluzivisht në fletën e të dhënave të tenderit dhe aty shumë qartë shkruan se tenderët dorëzohen përmes sistemit, ndërsa e paditura e dytë në arsyetimin e anulimit të tenderit por edhe në arsyetimin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, nuk ka dhënë ndonjë sqarim detal se ku shkruan në dosje që tenderët duhet të dorëzohen në formë fizike. E paditura e dytë po ashtu ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 44 të RRUOPP-së, ngase sipas kësaj dispozite ligjore tenderi mund të anulohet nëse gjatë përgatitjes së udhëheqjes së procedurës së prokurimit, është përdorur gabimisht opsioni për procedurën përkatëse dhe ky paraqet gabim të pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP-ja. Në rastin e paditësit nuk është respektuar procedura e parashikuar me këtë dispozitë ligjore. E paditura po ashtu ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, sepse paditësin nuk e ka trajtuar në mënyrë të barabartë, ngase dy operatorë tjerë ekonomik nuk kanë vepruar në përputhje me kërkesat nga pika IV.3.3. të njoftimit për konkurs të projektimit dhe nga pika 20.1 të kërkesës e fletës së të dhënave, andaj është e qartë ese e paditura ka bërë favorizime ndaj operatorëve tjerë ekonomik.

6. Tutje ka deklaruar se në interpretimin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik tutje KRPP shprehimisht thuhet se baza ligjore për përgatitjen e tenderëve është njoftimi për konkurs të projektimit dhe fleta e të dhënave të tenderit. Përpos kësaj, KRPP-ja me vendimin Nr. 48/2018 të datës 05.07.2018, i ka njoftuar Autoritetet Kontraktuese AK-të dhe operatorët ekonomik OE-të se nga data 01.09.2018 të gjithë tenderët me vlerë të madhe do të zhvillohen në formë elektronike dhe do të pranohen vetëm ofertat në formë elektronike dhe i vetmi OE i përgjegjshëm, nga aspekti i formës së aplikimit për tender, ka qenë paditësi. Vendimi i të paditurës së parë është kontradiktore dhe i kundërligjshëm, edhe pse në njërën anë, e paditura e parë e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, me arsyetimin se e paditura e dytë ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, ndërsa në anën tjetër e vërteton njoftimin për anulim të paditurës së dytë, me arsyetimin se kinse duke pasur parasysh mundësitë teknike të platformës elektronike, është e pamundur të bëhet hapja publike e ofertës. Një konstatim i tillë nuk qëndron për faktin se, hapja e ofertave mund të bëhet edhe pas kalimit të afatit për hapje publike të ofertave. Ko nuk ka ndodhur sepse e paditura e dytë me fajin e saj, nuk ju ka drejtuar me kërkesë të veçante KRPP-së. Ka theksuar se në emër të fitimit të humbur kërkon shumën prej 17,600.00 euro me kamatë ligjore prej 8 % duke u bazuar në dispozitën e nenit 136.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohen vendimet e nxjerra nga OSHP nr.PSH.936/20 i datës 09.11.2020, njoftimi i të paditurës nr.655-20-6077-2-1-3 i datës 03.11.2020 dhe vendimi i të paditurës së dytë nr.02-030/01-11897/20 i datës 30.10.2020, të detyrohet e paditura e dytë Komuna e Shtërpçës që paditësit në emër të dëmit real t'i kompensoj shumën prej 17,600.00 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive. Detyrohet e paditura e dytë që paditësit t'ia lëshoj një vërtetim me të cilin paditësit do t'i njihet si shërbim eksperience për projektin Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpës si dhe të detyrohet e paditura e dytë që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e përfaqësimit dhe ato të procedurës në shumën prej 540.80 për pjesëmarrjen në dy seanca gjyqësore, shumën prej 208 euro për padinë, dhe shumën prej 50 euro që paditësi ka paguar për taksë.

Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigje në padi sipas parashtresës së datës 27.12.2023, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, lidhur me pretendimin e OE ankues “Illyrian Consulting Engineers” SH.P.K se AK e ka anuluar aktivitetin prokurimit në kundërshtim me dispozitat e LPP-së Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore janë plotësisht të qëndrueshme pasi që AK anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk e ka bërë në përputhje me dispozitat e nenit 62 të LPP-së për arsye se nuk e ka bërë me kohë hapjen e ofertave në afatin e përcaktuar. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vërteton se në njoftimin për konkurs projektimi shkruan se dorëzimi i ofertave do të bëhet përmes e-sistemit, dhe njëkohësisht AK ka qenë në njohuri se nga viti 2018 të gjitha prokurimet udhëhiqen përmes e-prokurimit me përjashtim të kontratave me vlerë minimale. Prandaj edhe nëse janë dorëzuar oferta në formë fizike, nënkupton se kanë qenë oferta të pavlefshme dhe se ka qenë përgjegjësi e AK-së që ti përmbahet dispozitave të LPP-së që ofertat e pranuar në e-prokurim, ti hap në kohën e përcaktuar , edhe në rast se ka pasur paqartësi AK ka pas për obligim që me kohë ti bëjë korrigjimet e nevojshme dhe të shtyjë afatin e hapjes, e jo të pres të kalojë afati i hapjes publike, pasi që nënkupton se nëse hapja publike nuk bëhet në kohën siç është përcaktuar në e-prokurim të gjitha ofertat e dorëzuara përmes e-prokurimit digjen, që do të thotë se teknikisht është e pamundur të bëhet hapja e ofertave pasi të kalojë afati i rregullt për hapje, e që ka qenë data 27.10.2020. Në E-prokurim përveç që nuk gjendet oferta e OE ankues nuk gjenden as ofertat e tera, do të thotë se teknikisht e-prokurimi nuk i mundëson që të bëhet hapja publike pasi që ka kaluar afati i rregullt, andaj AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 58 të LPP-së dhe kjo bie ndesh me nenin 7 të këtij ligji dhe duke e pasur parasysh shkeljet procedurale të cilat kanë ndodhur për këtë aktivitet të prokurimit, është e pamundur që të vazhdohet më tutje dhe me këtë rast duhet të anulohet ky aktivitet në bazë të nenit 62 të LPP-së.

8. Përfundimisht ka deklaruar se, konsiderojnë se këtu nuk mund të bëhen fjale për fitimin e munguar për faktin se tanimë është konstatuar kjo se ofertat nuk janë hapur fare dhe me këtë fakt është me se e qartë se nuk ka favorizim të OE, për faktin se anulimi nuk nënkupton humbjen e të drejtës për aplikim dhe nuk ekziston asnjë fakt siç pretendon paditësi se nuk ka arritur të realizoj fitimin e tenderit për shkak se nuk e ka pasur të sigurt dhe nuk është e ditur se a mund të ishte fitues i tenderit. Gjithashtu konsiderojmë se në kontestin administrativ. Siç është parapare në legjislacionin në fuqi të gjitha vendimet e nxjerra i shqyrtohen gjykatës kompetente në konflikt Administrativ i cili siç dihet fillon vetëm ndaj organit të shkallës së dytë e në këtë rast ndaj OSHP. Prandaj nuk mund të merret parasysh fitimi i munguar sipas supozimit që do të mund të ndodhte, por mund të ishte marrë parasysh fitimi i humbur i cili në bazë të rrethanave objektive në mënyrë objektive pritet të ndodh, pasi që AP ka përfunduar duke mos hapur oferta, rrjedhimisht nuk ka ardhur deri tek nënshkrimi i kontratave dhe pretendimet e paditësit për kompensimin e fitimit të munguar nuk japin bazë të sigurt se një dëm i tillë është shkaktuar për faktin se këtu bëhet fjale për supozim të pretenduar se do të mund të ndodhte. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit “Illyrian Consulting Engineers” SH.P.K dhe të vërtetohet si i ligjshëm Vendimi Psh.nr. 936/20 i datës 10.12.2020 dhe i bazuar në dispozitat e LPP-së dhe LPA-së.

Provat e administruara

9. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar me nr. PSH 936/20 me datë 09.12.2020, Lista e dokumenteve të tenderit mbështetës për AP 655-20-6077-2-1-3 e dorëzuar nga paditësi, Formulari për dorëzimin e tenderit, Vendimi i AK për anulimin e AP me datë 30.10.2020, Njoftim mbi anulimin e AP me datë 03.11.2020, Kërkesë për rishqyrtim nga paditësi me datë 04.11.2020, Vendim i AK për refuzim të ankesës së paditësit me datë 06.11.2020, Ankesë e paditësit ILLYRIAN CONSULTING me datë 11.10.2020, Raport i ekspertit shqyrtues Agim Zeqiri me

nr.936/20 me datë 30.11.2020, Kundërshtim i ekspertizës nga përfaqësuesi i paditësit me datë 04.12.2020, Vendim me nr. 48/18 nga KRPP, Njoftim nga bordi i KRPP-së datë 05.09.2018, Llogaritja e fitimit të munguar nga paditësi, Marrëveshja mbi shërbim konsulence e lidhur mes paditësit ILLYRIAN Consulting Engineers ShPK dhe Kompanisë Arcitecture Gate SH.P.K., Faturë për shërbime sipas kësaj kontrate me nr.02/2024 me datë 10.02.2024, Marrëveshje për shërbime profesionale ligjore e lidhur në mes të paditësit ILLYRIAN Consulting Enginners ShPK dhe Abolivier & Associates, Urdhër transferi përmes bankës BKT, me datë 08.01.2021, shuma 2000 euro, Pagesë e faturës sipas kontratës nenit 4 pika 1. Germa A, Pagesë e faturës sipas kontratës nenit 4 pika 1. Germa B, Kërkesë për transfer në shumë prej 1500 euro sipas nenit 4 par.1 Germa C.

10. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.
11. Nga Vendimi i kundërshtuar me nr. PSH 936/20 me datë 09.12.2020, Paneli Shqyrtues e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE “Illyrian Consulting Engineers”, me seli në Tiranë, kundër njoftimit për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit si dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpçës me nr. Të prokurimit 655-20-6077-2-1-3, iniciuar nga AK kk Shtërpçe, vërtetohet njoftimi për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit si dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpçës me nr. Të prokurimit 655-20-6077-2-1-3, iniciuar nga AK “KK Shtërpçë”, me arsyetim se AK e ka anuluar aktivitetin prokurimit në kundërshtim me dispozitat e LPP-së Paneli Shqyrtues, siç konstatohet edhe nga ekspertit shqyrtues, anulimin i aktivitetit të prokurimit nuk është bërë në përputhje me dispozitat e nenit 62 të LPP-së për arsye se AK nuk e ka bërë me kohë hapjen e ofertave në afatin e përcaktuar. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vërteton se në njoftimin për konkurs projektimi shkruan se dorëzimi i ofertave do të bëhet përmes e-sistemit, dhe njëkohësisht AK ka qenë në njohuri se

nga viti 2019 të gjitha prokurimet udhëhiqen përmes e-prokurimit me përjashtim të kontratave me vlerë minimale. Prandaj edhe nëse janë dorëzuar oferta në formë fizike, nënkupton se kanë qenë oferta të pavlefshme dhe se ka qenë përgjegjësi e AK-së që ti përmbahet dispozitave të LPP-së që ofertat e pranuar në e-prokurim, ti hap në kohën e përcaktuar , edhe në rast se ka pasur paqartësi AK ka pas për obligim që me kohë ti bëj korrigjimet e nevojshme dhe të shtyjë afatin e hapjes, e jo të pres të kaloj afati i hapjes publike, pasi që nënkupton se nëse hapja publike nuk bëhet në kohën siç është përcaktuar në e prokurim të gjitha ofertat e dorëzuara përmes e-prokurimit digjen, që do të thotë se teknikisht është e pa mundur të bëhet hapja e ofertave pasi të kaloj afati i rregullt për hapje, e që ka qenë data 27.10.2020. Në E- prokurim përveç që nuk gjendet oferta e OE ankues nuk gjinden as ofertat e tjera, do të thotë se teknikisht e prokurimi nuk i mundëson që të bëhet hapja publike pasi që ka kaluar afati i rregullt, andaj AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 58 të LPP-së dhe kjo bie ndesh me nenin 7 të këtij ligji dhe duke e pasur parasysh shkeljet procedurale të cilat kanë ndodhur për këtë aktivitet të prokurimit, është e pamundur që të vazhdohet më tutje dhe me këtë rast duhet të anulohet ky aktivitetet në bazë të nenit 62 të LPP-së.

12. Sipas formularit për dorëzimin e tenderit. paditësi kishte aplikuar për aktivitetin e prokurimit me nr. AP 655-20-6077-2-1-3 me titull “ Hartimi i vlerësimi strategjik të mjedisit si dhe të hartës zonale të Komunës së Shtërpcës” dhe i ka dorëzuar dokumentet mbështetës.
13. Komuna e Shtërpcës si Autoritet Kontraktues me Vendimin e datës 30.10.2020, ka anuluar aktiviteti i prokurimit për tenderin “ Hartimi i vlerësimi strategjik të mjedisit si dhe të hartës zonale të Komunës së Shtërpcës”, me numër të prokurimit 655/020/029/213, dhe janë obliguar OE-të që kanë aplikuar për tender që më datë 02.11.2020, të bëjnë tërheqjen e ofertave në Komunën e Shtërpcës.
14. Sipas njoftim mbi anulimin e Aktivitetit të Prokurimit me datë 03.11.2020, aktiviteti i prokurimit është anuluar me arsyetim se ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të AK-së dhe të paparashikueshme, ngase AK Shtërpcë ka pranuar dy oferta në formë fizike dhe një ofertë në formë

elektronike. Komisioni i Hapjes i gjendur në këtë situatë ka konsultuar Dosjen e Tenderit dhe njoftimin në kontratë ku është vërejtur një gabim teknik i AK-së Shtërpcë ku në dosjen e tenderit thuhet se duhet të dorëzohet në formë fizike, por me një vend thuhet se duhet të dorëzohet përmes sistemit. Për këtë arsyeje AK merr vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit në pajtim me ligjin e prokurimit.

15. Pas anulimit të tenderit me datë 04.11.2020, “Illyrian Consulting Engineers”, i është drejtuar AK-së Komunës së Shtërpcës me kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit 655-20-6077-2-1-3, sa i përket tenderit me titull “ Hartimi i vlerësimi strategjik të mjedisit si dhe të hartës zonale të Komunës së Shtërpcës” .
16. AK Komuna e Shtërpcës me Vendim të datës 06.11.2020 ka refuzuar ankesës e parashtruar nga OE “Illyrian Consulting Engineers”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i vlerësimi strategjik të mjedisit si dhe të hartës zonale të Komunës së Shtërpcës”, dhe është vërtetuar njoftimi për anulim të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Hartimi i vlerësimi strategjik të mjedisit si dhe të hartës zonale të Komunës së Shtërpcës”, me numër të prokurimit 655/020/029/213.
17. Paditësi “Illyrian Consulting” me datë 11.10.2020, ka parashtruar ankesë në OSHP për aktivitetit të prokurimit me numër 655-20-6077-2-1-3, me titull “ Hartimi i vlerësimi strategjik të mjedisit si dhe të hartës zonale të Komunës së Shtërpcës”.
18. Nga Raport i ekspertit shqyrtues Agim Zeqiri me nr.936/20 me datë 30.11.2020, eksperti shqyrtues ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë plotësisht të qëndrueshme pasi që AK anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk e ka bërë në përputhje me dispozitat e nenit 62 të LPP-së, për arsye se nuk e ka bërë me kohë hapjen e ofertave në afatin e përcaktuar. Në njoftimin për konkurs projektimi shkruan se dorëzimi i ofertave. Duke iu referuar këtij aktiviteti të prokurimit AK nuk e ka respektuar dispozitat e nenit 58 të LPP-së, dhe kjo bie ndesh me dispozitat e nenit 7 të këtij ligji, andaj pretendimet ankimore konsiderohet të bazuara, por duke pasur parasysh mundësitë teknike të platformës elektronike është e pa mundur të bëhet hapje publike e ofertave, andaj eksperti shqyrtues i ka rekomanduar panelit

shqyrtues që vendimi i AK-së të mbetet në fuqi edhe përkundër parregullsive që janë bërë nga AK-ja.

19. Më datë 04.12.2020, përfaqësuesi i paditësit “Illyrian Consulting Engineers”, e ka kundërshtuar ekspertizën me numër 9369/20 të datës 04.12.2020, me arsyetim se eksperti shqyrtues nuk ka vepruar sipas ligjit dhe nuk e ka aplikuar atë si duhet për rrethanat e krijuara me ç’rast kundërligjshëm ka dhënë mendim që të përkrahet vendimi i AK-së.
20. Nga Vendim me nr. 48/18 nga KRPP, konstatohet se Komisioni Rregullativ i Prokurimit kishte marr vendim që të gjitha aktivitetet e prokurimeve të centralizuar të cilat do të zhvillohen nga Agjencia Qëndrore nga data 05.07.2018 do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave. Të gjitha aktivitetet e prokurimeve me vlerë të madhe të cilat do të zhvillohen nga AK nga data 01.09.2018 do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave dhe me këtë vendim i është lejuar të gjitha AK-ve që në të gjitha aktivitetet e prokurimit të vendosin kushtet dhe të pranojnë nga operatorët ekonomik, vetëm ofertat e dorëzuara në formë elektronike.
21. Me njoftim të datës 05.09.2018, KRPP-ja u ka rikujtuar të gjitha Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomik se nga data 03.09.2019 janë të obliguar të zbatojnë vendimin Nr. 48/2018 dhe ndryshim plotësimet e RrUOPP-së, në atë se të gjitha aktivitetet e prokurimeve me vlerë të madhe të cilat do të zhvillohen nga AK nga data 01.09.2018 do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave dhe me këtë vendim i është lejuar të gjitha AK-ve që në të gjitha aktivitetet e prokurimit të vendosin kushtet dhe të pranojnë nga operatorët ekonomik, vetëm ofertat e dorëzuara në formë elektronike, AK-të për të gjitha procedurat me vlerë të madhe duhet të cekin në njoftimet për kontratë dhe FTD të Dosjes së Tenderit neni 19.1.h, që tenderi të dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike dhe në asnjë mënyrë në version tjetër, kjo do të jetë kusht i tenderit i cili duhet respektuar për të mundësuar pranimin e ofertës si të përgjegjshme.

22. Llogaritja e fitimit të munguar nga paditësi, është llogaritur në shumë të përgjithshme prej 129,150.00 euro.
23. Me datë 07.10.2020 është lidhë Marrëveshje mbi shërbim konsulence e lidhur mes paditësit Illyrian Consulting Engineers ShPK dhe Kompanisë Arcitecture Gate SH.P.K, në mes të palëve Illyrian Consulting Engineers ShPK dhe Kompanisë Arcitecture Gate SH.P.K, me qëllim të dhënies së konsulencës dhe të përgatitjes së dokumenteve ligjore, financiare profesionale dhe të propozimit financiar për konkursin e projektimit me titull “Hartimi i vlerësimi strategjik të mjedisit si dhe të hartës zonale të Komunës së Shtërpçës”. Pagesa është sipas kësaj kontrate me nr.02/2024 është realizuar me datë 10.02.2024, Fatura me titull faturimi i dërgesave, mallrave dhe shërbimeve kundrejt porosive të blerjes, në shumë totale prej 9,600.00 euro.
24. Ndërsa paditësi “Illyrian Consulting Enginners”, më datë 11.10.2020, Marrëveshje ka nënshkruar Marreveshje për shërbime profesionale ligjore për qëllime të shërbimeve profesionale ligjore me përfaqësuesin e autorizuar “ShPK dhe Abolivier & Associates”. Pagesat janë realizuar nga Urdhër transferi përmes bankës BKT me datë 08.01.2021, shuma 2000 euro, dhe në shumë prej 1500 euro.

Baza Ligjore

25. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Neni 6 paragrafi 1 përcakton “Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”, paragrafi 2 parasheh “Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës” Neni 7 përcakton Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 parasheh se “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, paragrafi 2 parasheh se

“Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik”. Neni 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se “*Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar*”, 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji”. Neni 58 Hapja e Tenderëve 1. Tenderët e pranuar në një aktivitet prokurimi të kryer duke përdorur procedurat e hapura apo të kufizuara do të hapen vetëm publikisht. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit vendin dhe kohën e hapjes së tenderëve. Nëse autoriteti kontraktues, në përputhshmëri me këtë ligj e nxjerr një dokument, duke e autorizuar zgjatjen e afatit kohor për dorëzimin e tenderëve, autoriteti i tillë kontraktues, në dokumentin e tillë duhet të specifikojë afat të ri kohor për hapjen e tenderëve. Afati i caktuar për hapjen publike të tenderëve duhet të jetë menjëherë pas afatit të fundit kohor të caktuar për pranimin e tenderëve.

26. Neni 62 përcakton Përfundimin e Aktivitetit të Prokurimit paragrafi 1 parasheh se . “*Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit 1.2. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo 1.3. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit*”. Neni 117 përcakton se “*Afati i fundit për marrjen e vendimeve 1. OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe*

ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij” .

27. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik neni 44 pika 7 parasheh se *Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme: “(i) për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve”; (ii) “nëse AK gjate përgaditjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm”; (iii) “është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar, brenda kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP”.*

Vlerësimi i gjykatës

28. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.
29. Gjykata vlerëson se paditura në Vendimin e kundërshtuar me nr. PSH 936/20 me datë 09.12.2020, e ka vërtetuar drejt gjendjen faktive dhe ka marrë vendim të drejtë

duke aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën e OE “Illyrian Consulting Engineers”, me seli në Tiranë, kundër njoftimit për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit si dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpçës me nr. të prokurimit 655-20-6077-2-1-3, iniciuar nga AK KK Shtërpçe, sepse gjykata e vlerëson si të drejte dhe të bazuar në dispozitat ligjore vlerësimin e Panelit Shqyrtues se AK – Komuna e Shtërpçës, e ka anuluar aktivitetin prokurimit në kundërshtim me dispozitat e LPP-së nenit 62 të LPP-së, për faktin se AK ka qenë në njohuri se nga viti 2019 të gjitha prokurimet udhëhiqen përmes e-prokurimit me përjashtim të kontratave me vlerë minimale, sipas Vendim të Komisionit Rregullativ të Prokurimit me nr. 48/18 që të gjitha aktivitete të prokurimeve të centralizuar të cilat do të zhvillohen nga Agjencia Qendrore nga data 05.07.2018 do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë dhe dorëzimin e ofertave dhe të gjitha aktivitetet e prokurimeve me vlerë të madhe të cilat do të zhvillohen nga AK nga data 01.09.2018 do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave. Po ashtu me datës 05.09.2018, KRPP-ja ju ka rikujtuar të gjitha Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomik se nga data 03.09.2019 janë të obliguar të zbatojnë vendimin Nr. 48/2018 dhe ndryshim plotësimet e RrUOPP-së, në atë se të gjitha aktivitetet e prokurimeve me vlerë të madhe të cilat do të zhvillohen nga AK nga data 01.09.2018 do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave.

30. AK e ka pasur të detyrueshme që në të gjitha aktivitetet e prokurimit të vendos si kusht për të gjitha procedurat me vlerë të madhe të cek në njoftimet për kontratë dhe FTD të Dosjes së Tenderit neni 19.1.h, që tenderi të dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike dhe në asnjë mënyrë në version tjetër, dhe të pranojnë nga operatorët ekonomik vetëm ofertat e dorëzuara në formë elektronike. Përkundër detyrimit ligjor AK KK Shtërpçe në Dosjen e Tenderit dhe njoftimin në kontratë përcakton dosja e tenderit të duhet të dorëzohet në formë fizike, ndërsa në një vend thuhet se duhet të dorëzohet përmes sistemit.
31. Gjykata vlerëson se Paneli Shqyrtues me të drejtë dhe në përputhje me Nenin 62 ku përcaktohet Përfundimin e Aktivitetit të Prokurimit paragrafi 1: “*Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë*

në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, e ka vlerësuar se shkelja e AK që ka ndodhur në procedurën e prokurimit nuk mund të rregullohet, sepse AK-së përveç paqartësive rreth dosje te tenderit rreth mënyrës se dorëzimit, nuk i ka hap në kohën e përcaktuar ofertat e pranuar në e-prokurim, dhe nuk ka bërë korrigjimet e nevojshme dhe të shtyjë afatin e hapjes, e jo të pres të kaloj afati i hapjes publike, pasi që kjo ka rezultuar që të gjitha ofertat e dorëzuara përmes e-prokurimit të digjen, që do të thotë se teknikisht është e pamundur të bëhet hapja e ofertave pas kalimit të afati i rregullt për hapje (pas datës 27.10.2020).

32. Prandaj gjykata vlerëson se e paditura në vendimin e kundërshtuar nuk ka pasur tjetër mundësi përveç se ta konstatoj shkeljen, sepse hapja respektivisht vazhdimi i procedurës së prokurimit është bërë teknikisht i pamundur, sepse AK nuk ka i respektuar dispozitat e nenit 58 të LPP-së në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe duke e pasur parasysh shkeljet procedurale të cilat kanë ndodhur në procedurë në këtë aktivitet të prokurimit, është e pamundur që të vazhdohet më tutje dhe ka vlerësuar se duhet të anulohet ky aktivitetet në bazë të nenit 62 të LPP-së.
33. Për çka AK për shkeljet cituara më sipër është ligjërisht e obliguar që ti kompensoj dëmin real të shkaktuar paditësit lidhur më shpenzimet e bërë në procedurën e aplikimit, konfom Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku përcaktohet përgjegjësia për dëmin e shkaktuar, Neni 9 *Ndalimi i shkaktimit të dëmit* *Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t'i shkaktoj dëm tjetrit. Neni 136 Bazat e përgjegjësisë 1. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. 2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji. 3. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj, dhe Neni 137 Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur).*

34. Mirëpo gjykata vlerëson se kërkespadi e paditësit për kompensim të dëmit real nuk është e mbështetur në prova të besueshme, sepse pagesat e realizuara sipas Kontratës nr.02/2024 së datës 07.10.2020 të lidhur mes paditësit Illyrian Consulting Engineers ShPK dhe Kompanisë Arcitecture Gate SH.P.K për shërbim konsulence, janë realizuar me datë 10.02.2024, që i bie pas seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 07.02.2024, ndërsa shërbimet pretendohet se janë kryer në kohën e aplikimit për aktivitetin e prokurimit me titull “ Hartimi i vlerësimit strategjik të mjedisit si dhe hartës zonale të Komunës së Shtërpçës me nur. Të prokurimit 655-20-6077-2-1-3, iniciuar nga AK kk Shtërpçe, në vitin 2020, për çka gjykata nuk jua fali besimin. Sepse, sipas LPK Neni 428 paragrafit 1 paditësi do të duhej ti paraqiste te gjitha faktet dhe provat me padi për vërtetimin e pretendimeve te tij, ndërsa sipas par.2 *Palët gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor mund të paraqesin fakte të reja, dhe të propozojnë prova të reja, vetëm po që se e bëjnë të besueshme rrethanën se pa fajin e tyre nuk kanë mundur t’i paraqesin*, prandaj provat materiale për demin real paditësi do të duhet ti paraqiste me padi, por edhe pse gjykata ia mundësoj që ti dorëzoj në seancë të shqyrtimit kryesor, nga provat materiale nuk u vërtetua se shpenzimet ishin realizuar në kohën e përgatitjes/dorëzimit të tenderit në vitin 2020, prandaj gjykata nuk ua fali besimit.
35. Sa i përket kërkesës për kompensim të fitimit të humbur gjykata refuzoj propozimit që të merret prova me ekspertize për ta saktësuar fitimin e humbur, sepse pjesëmarrja në aktivitet të prokurimit nuk nënkupton se paditësi do të ishte shpallur fitues dhe do të realizonte kontratën, sipas nenit Neni 173 të LMD-së përcaktohet Dëmi i real dhe fitimi i humbur *1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.[...] 3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerr veprimin*, ndërsa vetëm aplikimi në procedure të prokurimit nuk nënkupton se paditësi do të realizonte kontratën/respektivisht të priste fitimin në mënyrë të bazuar, sepse ofertë do ti nënshtrohet vlerësimit dhe do të vlerësohej

plotësimi i disa kritereve, siç janë kriteret e përshtatshmërisë profesionale, teknike, çmimi etj, për të cilat paditësi nuk e ka dëshmuar se në rastin konkret i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe se dhënia e kontratës ishte mënyrë të bazuar e pritshme që të realizohet.

36. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
37. Lidhur shpenzimet procedurale ku bëjnë pjesë edhe shpenzimet e përfaqësimit gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.968/22, datë 11.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.